



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 06-387/2025

Datë: 05.02 /2025

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17, 38, 60 dhe 61 Ligjit për Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 , nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenit 92 të Statutit të Komunës, me kërkesën e drejtoris për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 31.01.2025.mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shtim të buxhetit për projektin “ **Furnizim me mjete bujqësore-Lot 1-Motokultivator me Frezë**” Në shumë prej: **11,802.00** euro Kategoria Ekonomike Subvencione dhe Transfere.
2. Projekti “**Furnizim me mjete bujqësore-Lot 1-Motokultivator me Frezë**” 30% mbulohet nga mjetet e participimit me qytetarë kurse pjesa tjetër prej 70% do të mbulohet nga Komuna, kategoria ekonomike **Subvencione dhe transfere**, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kodi i programit (47018)
3. Komuna financo me mjete financiare në shumë prej **27,538.00** euro nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kodi programit (47018) kurse qytetarët kanë participuar me mjete në vlerë prej **11,802.00** euro, vlera e tërësishme e projektit është **39,340.00** euro.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënljgore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Drejtoria për Bujqësi zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi.**

Kryesues i Kuvendit
Fadik Gashi

